Përjashtime nga pagesa për tarifat (pastrim, ndriçim, gjelbërim)

dh)Përjashtohen nga pagesa e tarifave për vitin 2026 të gjithë Komunitetet fetare të njohura me ligj si dhe ato organizatat jofitimprurëse që objekti kryesor i aktivitetit të tyre është me karakter fetar.
e). Përjashtohen nga pagesa e tarifave për vitin 2026 të gjithë fermerët që janë regjistruar me NIPT sipas vërtetimit nga Drejtoria Rajonale Tatimore sipas udhëzimit Nr. 19, datë 3.11.2014, "Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar"
ë) Përjashtohen nga pagesa e tarifave për vitin 2026 kryefamiljaret femra me status e divorcuar, e ve si dhe kryefamiljaret e vetme.
f). Përjashtohen nga pagesa e tarifave vendore familjare (pastrim, ndriçim, gjelbërim) për vitin 2026 të gjitha familjet jo efektive të cilat pas verifikimeve të përsëritura nga administrata dhe nga njësitë respektive për njësitë e tjera administrative nuk gjenden në banesë dhe nuk banojnë në adresën e deklaruar.
g). Përjashtohen nga pagesa e tarifave vendore familjare (pastrim, ndriçim,gjelberim) për vitin 2026 të gjitha familjet në fshatrat e njësive administrative në të cilat nuk kryhen këto shërbime.
Per hartimin e Paketa Fiskale 2026 është konsultuar me Drejtorit e Bashkise Prrenjas, Policia Bashkiake dhe Njesit Administrative, degjesat publike si dhe realizimi i te ardhurave te parashikuara ne PBA 2025-2027.

ANKIMIMET

Çdo taksapagues ka të drejtë të ankohet me shkrim për shumën dhe mënyrën se si janë vlerësuar detyrimet e tij, si dhe të apelojë kundër cdo veprimi ose mosveprimi nga strukturat e Drejtorive përkatëse pranë Bashkisë Prrenjas

Çdo tatimpagues që e sheh të padrejtë vlerësimin e detyrimit tatimor apo gjobat e vendosura nga Sektori i Tatim-Taksave të Bashkisë, ka të drejtë të ankohet tek komisioni i apelimit tatimore të emëruar nga kryetari i bashkisë.

- Ankimi paraqitet me shkrim brenda **30 ditëve** nga marrja dijeni për aktin administrativ, dhe përmban:
    a) Emrin, adresën dhe NIPT-in e apeluesit;
    b) Vitin tatimor me të cilin lidhet apelimi;
    c) Natyrën dhe shumën e tatimit ose gjobës që është subjekt apelimi;
    d) Baza ku mbështetet apelimi;

- Përgjigjia e ankesës do të merret me shkrim nëpërmjet postës, sipas vendimit të dalë nga komisioni i apelimit tatimor, mbështetur në rregulloren e apelimit tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak.
- Një kopje të vendimit, komisioni i apelimit tatimor e dërgon në Sektorin e Tatim Taksave për ndryshimin ose jo të akt-detyrimit .